

## PËRMBAJTJA IDEOEMOCIONALE E VALLËZIMIT POPULLOR SHQIPTAR<sup>1</sup>

Ramazan Bogdani

KUD 394.3 (497.115)  
Punim studimor

Tiranë

Marrë për botim më 10.XII.1994

Përmbajtja e shkurtër: Punimi trajton vallet shqiptare në aspektin e përmbajtjes ideoemocionale. Vallet ndahen në dy gjini kryesore -epikë dhe lirikë e pastaj brenda tyre llojet e tjera. Kriter për përcaktimin gjinor të valleve konsiderohet plastika koreografike.

Vallet tona popullore mund të shqyrtohen sipas përmbajtjes ideoemocionale, shtrirjes etnografiko-koreografike, mjeteve shprehëse artistike etj. Në këtë punim ne do t'i studiojmë ato vetëm nga pikëpamja ideoemocionale. Mbi bazën e një lëndë të gjallë e të pasur koreografike, kryesisht të filmuar, të vjelë gjatë tre-katër dhjetëvjeçarëve të fundit, do të përpiqemi të ndriçojmë aspekte të brendisë ideoemocionale të valleve tona popullore.<sup>2</sup> Një studim i tillë do të krijojë në të ardhmen mundësinë e shqyrtimeve krahasuese me vallëzimin e popujve të tjerë, veçanërisht të Ballkanit.

\* \* \*

Në përmbajtjen ideoemocionale të vallëzimit tonë popullor dallohen dy gjini kryesore; lirika dhe epika. Nocionet e lirikës dhe të epikës, që përdoren për të karakterizuar folklorin në tërësi, kanë nevojë që të specifikohen më tej brenda fushës së koreografisë popullore. Që të mund të zgjidhet drejt kjo çështje është e domosdoshme të nisemi nga thelbi estetik i veçantë i valles.

1 Punimi është marrë në *Çështje të folklorit shqiptar 4*, Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Kulturës Popullore, Tiranë, 1989, f.351-374.

2 Disa nga këto probleme autori i ka trajtuar në mënyrë të pjesshme fillimisht në një punim të mëparshëm: *Sprovë për një klasifikim shkencor të folklorit koreografik në vështrim gjinor krahinor dhe strukturor*. "Studime folklorike", Tiranë, 1975, nr.2; f.157-171.

Dihet se krijimtaria koreografike ka qenë e mpleksur edhe me fusha të tjera të artit popullor. Ajo ka pasur lidhje me praktika magjike, më rituale etj. Në kohën tonë, vallet qarkullojnë kryesisht si krijimtari artistiko-es-tetike, ato janë çliruar nga funksionet tjera që kanë pasur në të kaluarën. Koreografia popullore përbën një krijimtari specifike artistike, e cila është jo vetëm art, por edhe një lloj i veçantë arti, që, ashtu si folklori në tërësi, shquhet për: karakterin kolektiv, anonim e improvizues, frymën popullore e kombëtare etj. Themelore në këtë lloj arti është të pasqyruarit e realitetit objektiv nëpërmjet lëvizjes, plastikës, gjestit, pra, nëpërmjet kërcimit. Ndryshe ndodh në poezi dhe në muzikë, të cilat e shprehin realitetin, përkatësisht me anë të fjalës poetike dhe tingullit muzikor.

Kur flasim për vallet, duhet mbajtur fort parasysh karakteri i brendshëm sinkretik i tyre; ato shpesh janë të lidhura me fillesën artistike muzikore dhe me fillesën artistike poetike. Prandaj, mjaft prej tyre nuk mund të kuptohen jashtë këtij realiteti, d.m.th. të shkëputura nga poezia dhe muzika. Megjithatë jo të gjitha vallet nënkuptojnë si elemente të tyre të domodoshme edhe fillesën muzikore, edhe fillesën letrare. Vallja mund të bëjë jetë edhe pa këto fillesa artistike dhe përsëri të karakterizohen nga një varg tiparësh të individualizuara, madje të kristalizuara, të cilat, në një masë të konsiderueshme, i ka si vallja me shoqërim poetik, ashtu edhe ajo me shoqërim muzikor.

Si rrjedhim, kriteri më i rëndësishëm për të përcaktuar vallen në tërësi dhe klasifikimin e saj gjinor në veçanti, është plastika koreografike<sup>3</sup>. Përbërësit kryesorë të plastikës koreografike janë: lëvizjet e këmbëve, veprimet e trupit, pozicionet e duarve, qëndrimet e kokës. Natyrisht këto hallka shprehëse artistike nuk janë të ndara nga njëra-tjetra, ato harmonizohen e njësohen plotësisht dhe tërësia e tyre jep atë që quhet plastikë koreografike.

Në vallëzimin popullor, ndarja sipas gjinisë parakupton në mënyrën aprioristike dallimet midis plastikës koreografike lirike dhe plastikës koreografike epike. Në vështrim të përgjithshëm morfologjik, plastika koreografike lirike shprehet në struktura kërcimi të tilla si: zhvendosjet e qeta të buta dhe të lehta të këmbëve apo hapat e rrafshët që përgjithsisht nuk ngrihen nga toka: hedhjet e vogla pupthi mbi njerën ose të dyja këmbët apo ecjet pa hapa të dyfishuar; lëvizjet rrëshqitëse apo zhvendosjet zvarë të këmbëve; hapat e thjeshtë në formën e ecjes së zakonshme; thyerjet e vogla apo uljet e buta mbi njerën ose të dyja këmbët; zhvendosjet karakteristike hap pas hapi; ecjet plot delikatesë në majë të gishtërinjve; hapat e vegjël me të dyja këmbët njëra me tërë shuallin dhe tjetra pak me thembër; nxjerrja me finesë e njërës këmbë përpara pak në majë të gishtërinjve;

<sup>3</sup> Përmbajtja ideoemocionale e një valleje vërtet ndërvarët prej plastikës koreografike, po në të luan rol të veçantë fabula. Ashtu si në fushat e tjera të artit popullor, edhe në koreografi fabula tregon një ndodhi nëpërmjet elementeve artistike-vallëzuese dhe shprehive psikologjike e botëkuptimore të vetë interpretuesve. Në valle ushtrojnë rolin e vet të pazëvendësueshëm edhe mjete të tjera shprehëse artistike. Këta tre tregues (plastika koreografike, fabula, mjetet shprehëse artistike) përbëjnë kritere themelore për vëzhgimin ideoemocional të valles popullore në tërësi.

kthesat e lehta apo rrotullimet e gjera; qëndrimet e trupit drejt e hijshëm apo dallgëzimet valë-valë gjatë zhvendosjes; kapjet elegante zinxhir të duarve apo lëvizjet e tyre të lira e të gjera; shikimet e qeta plotë fisnikëri etj. Në këtë mënyrë, plastika koreografike lirike karakterizohet nga kërcimi i shtruar, i butë, me finesë dhe elegancë kërcim që, përfton një gjendje emocionale, në përgjithësi, të ngrohtë dhe të qetë. Për të konkretizuar plastikën koreografike lirike, le të kujtojmë "Vallen e 25 gërshetare" të fshatit Dardhë të rrethit të Korçës<sup>4</sup>.

Në një vështrim po aq të përgjithshëm sa plastika koreografike lirike, plastika koreografike epike shprehet me struktura kërcimi të tilla, si: zhvendosjet e theksuara apo ndalesat e prera me një rën ose të dyja këmbët: Përplasjet e forta të hapave në tokë apo kalimet e herëpashershme të tyre në majë të gishtërinjve: ngritjet e mëdha e të gjera shprehëse të këmbëve gysmë të thyera në ajër: hedhjet e vrullshme nga toka dhe uljet e thella e të befta mbi një rën ose të dyja këmbët; kthesat e forta apo rrotullimet energjike; ngjeshja brinjë me brinjë e valltarëve në grup apo qëndrimi krenar i kërcimeve vetjake; përkuljet e prera apo pozicionet monumentale të trupit kapjet e forta të duarve e të krahëve apo lëvizjet e zhdërvejlta të tyre; shikimet e thella dhe të mprehta etj. etj. Pra, plastika koreografike epike karakterizohet nga kërcimi i gjallë, i fortë, dinamik, impulsiv, kërcim që përfton një gjendje emocionale, në përgjithësi, krenare dhe burrërore.

Plastika koreografike epike, me kërcyeshmërinë zhvilluese, zhdërvjelltesinë dinamike dhe ekspresivitetin, reflektohet mjaft qartë në të gjitha vallet tona epike. Por herë-herë, elemente të veçanta ose të përbashkëta të saj arrijnë të pasqyrojnë edhe figura simbolike të caktuara.<sup>5</sup>

Megjithëse ndarja e valleve në lirike dhe epike, siç u pa, ka kriteret e veta, nuk është e mundur që ato të përcaktohen gjithmonë saktë në një gjini

4 Të tre hapat e lajtmotivit koreografik (një i madh e dy të vegjël) zhvendosen në formë rrëshqitëse dhe shtytëse. Ata i karakterizon lëvizshmëria e gjerësia, lehtësia e ngadalësia. Reflekse të karakterit lirik të plastikës koreografike të këtij krijimi japin edhe lëkundjet valëzuese, me ngritjen e uljen vertikale të trupit, kapja e lehtë zinxhir e duarve dhe vështrimet e qeta të valltarëve. Në këtë mes spikatin gjithashtu improvizimet e valltares së parë: pasi shkëputet nga grupi, ajo kërcen me gjysmëkthesa dhe rrotullime elegante, me shaminë lart, të mbajtur sipas traditës vendase nga të dy cepet: apo kërcimi për një çast i dy valltareve të para në qendër të rrethit, veprime këto që krijojnë plane kontrastuese të larmishme në tërësinë koreografike. Natyra lirike e plastike së kësaj valle nuk mund të merret e shkëputur nga bota e brendshme psikologjike-shpirtërore e valltareve. Së fundi teksti poetik erotik dhe melodika e qetë plot dritë përforcojnë gjithashtu fizionominë e përgjithshme lirike të plastikës së valles

5 Sipas të moshuarve tropojas, p.sh., në kërcimet e tyre gjejnë mishërim dukuri të tilla, si fluturimi i sokolit dhe i shqiponjës. Por bartësit shkojnë edhe më tej, duke pohuar se pothuajse çdo lëvizje e valltarëve shpreh një lloj mendimi. Kështu, duart e grushtuara. të cilat rrotullohen herë në drejtime paralele e herë në drejtime të kundërta, ngritjet dhe uljet e theksuara të këmbëve në tokë, kthesat e prera të trupit dhe veçanërisht forca interpretuese e valltarëve, skalitin portretin madhështor të malësorit shqiptar që me pushkë në dorë ka luftuar gjithë jetën kundër armiqve. Shoqërimi vetëm me lodër sikur e thekson më tepër karakterin luftarak e trimëror të valles. Një karakter i tillë, natyrisht, kushtëzohet në radhë të parë nga temperamenti e psikologjia e tropojanëve. Mendojmë se ai vjen gjithashtu edhe nga kushtet gjeografike e klimaterike etj.

në caktuar. Në një valle popullore, herë-herë, ndërthuren elemente lirike dhe epike së bashku. Gjithashtu, brenda secilës gjini ka zhanre apo lloje të ndryshme. Ndarja e valleve në lloje bëhet duke u nisur nga përmbajtja ideoemocionale, e cila përftohet në unitetin koreografi-muzikë-tekst, si dhe nga forma artistike e tyre - tërësia e mjeteve shprehëse koreografike, muzikore, poetike. Të vërejmë tani konkretisht ndarjen e brendshme të valleve lirike dhe të valleve epike.

**Vallet lirike.** Në krahasim me vallet epike, vallet lirike zënë një vend më të madh në folklorin koreografik shqiptar. Ato dallohen për thjeshtësinë e lëvizjeve, të motiveve dhe të figurave koreografike. Në to mbizotëron poetika kërcyese e mbushur me delikatesë, finesë dhe elegancë. Vallet lirike luhen kryesisht nga gratë, më pak nga burrat ose gra e burra së bashku. Duke iu përmbajtur kriterëve që parashtruan dhe ligjësorive të përgjithshme të estetikës së koreografisë sonë popullore, ato grupohen në këto lloje: 1 - *Valle lirike të punës*; 2 - *Valle lirike rituale*; 3 - *Valle lirike të dasmës*, 4 - *Valle lirike erotike*; 5 - *Valle lirike humoristike*; 6 - *Valle lirike pantomimë*. Llojet e lirikës pasqyrohen herë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe herë në mënyrë të tërthortë. Në një valle rastis të ndërthuren edhe elemente të dy llojeve të lirikës njëherësh. Në raste të tilla elementet mbizotëruese përcaktohen nga analiza morfologjike e plastikës koreografike.

*Vallet lirike të punës*<sup>6</sup>. Rezultatet e deritanishme tregojnë se në repertorin e valleve tona popullore numërohen pak valle pune. Këto krijime, që ekzistohen dhe luhen nga populli edhe sot e kësaj dite, përgjithësisht karakterizohen nga thjeshtësia e mjeteve shprehëse artistike, por ruajnë forcë të madhe emocionale. Burimet gojore dëshmojnë se në të kaluarën valle të tilla kanë ekzistuar më shumë dhe se ato, si pjesë e gjallë e koreografisë popullore, kishin karakter bifunksional, domethënë plotësonin njëkohësisht funksione estetike dhe praktiko-utilitare. Me kalimin e kohës disa prej tyre u zbehën së tepërmi. Ka edhe këngë, tekstet poetike të cilave dëshmojnë se në të kaluarën duhet të kenë qenë praktikuar si valle pune, ndërsa aktualisht ekzekutohen thjesht si krijime humoristike.

Vallet e punës luhen zakonisht prej grave. Ndonëse disi e zbehtë, përmbajtja e tyre lidhet, kryesisht me punët blegtorale (shih "Vallen e mjeljes"<sup>7</sup> - krahina e Hasit, (rrethi Kukës) dhe me punët bujqësore ("Vallet e mbjelljes"<sup>8</sup>, Zadrimë, rrethi Shkodër. Këto dëshmojnë hershmërinë e tyre.<sup>9</sup> Në këto valle ndeshen veprime fillestare koreografike, që kanë qenë të lidhura me praktika të lashta rituale.<sup>10</sup>

6 Më gjerë për këtë shih: R. Bogdani. Të dhëna për vallet follarike shqiptare të punës, "Studime filologjike", Tiranë, 3/1977, f.87-100

7 AIKP (Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore), KF (Kino-filmoteka), përkatësisht, KF (kinofilmi) nr.2/1 (quajtur "Po shkon vjerra me mjel lopën"); 12/2

8 AIKP (Arkivi i Institutit të Kulturës Popullore). KF (Kino-filmoteka), përkatësisht, KF (kinofilmi) nr.2/1 (quajtur "Po shkon vjerra me mjel lopën"); 12/2

9 Në fakt më të lashta janë vallet për gjuetinë, por ne s'kemi mundur të gjejmë ndonjë krijim të tillë

10 Sipas traditës, gjatë punëve blegtorale dhe bujqësore (p.sh., në stane gjatë punimit të bulmetrave, në mbjellje ose në lëmë gjatë shirjes së të lashtave etj.) praktikoheshin edhe valle, duke krijuar kështu një mjedis të gjallë folklorik. Ato ishin dy llojesh; të parat lidheshin

Vallet që lidhen me artizanatin popullor ("Vallja e tjerres"<sup>11</sup> - Leskovik, rrethi Kolonjë) dhe punët shtëpiake ("Vallja e brumit"<sup>12</sup> - Nahija e Podgurit - Kosovë), ndonëse më të vonshme në krahasim me ato të blegtorisë e të bujqësisë, i zgjerojnë dhe i pasurojnë vallet lirike të punës.

Në vallet e punës ka një unitet ideoestetik të dukshëm midis fillesës koreografike, muzikës dhe tekstit poetik, të cilët mishërojnë së bashku përfytyrimet estetike të njeriut për punën. Shumica e tyre përdoren si valle të kënduara, me një natyrë entuziaste e optimiste, me shije të spikatur artistike.

2. - *Vallet lirike rituale*. Siç dihet, elementet ritualistike të lidhura me një kult të caktuar, të cilat shfaqen në doke, zakone, lodra dhe në fusha të ndryshme të krijimtarisë popullore, i përkasin një kulture të hershme. Duke u gërshetuar me veprime të thjeshta koreografike, herë-herë edhe dramatiko-pantomimike, ato kanë formuar një pjesë të gjallë të vallëzimit popullor. Në vallet rituale, ndoshta më tepër se në çdo lloj tjetër të lirikës sonë koreografike, elementet e kërcimit, ku më shumë e ku më pak, paraqiten të kursyera e të thjeshta, por me shprehje artistike të larta.

Siç dihet, brenda disa zhanreve, duke përfshirë edhe vallet rituale, në kushtet e sotme shoqërore veprimtaria krijuese ka shterrur përfundimisht me kalimin e kohës, disa prej elementeve ritualistike nisën të dalin nga praktika koreografike dhe vallet humoristike humbën funksionin ritualistik - ato fituan kësaj më tepër një përmbajtje humoristike. Ndaj, më së shumti, valle të kësaj natyre, ndryshe nga ato të punës, qarkullojnë kryesisht si vlera artistike monofunksionale.

Vallet rituale në bazën e tyre kanë pasur edhe domethënie shoqërore. Ato shprehin gëzimin për ardhjen e pranverës (Vallja "Lule manushaqe"<sup>13</sup> - rrethi Kolonjë), dëshirën për shtimin e prodhimit ("Vallja e jeremisë"<sup>14</sup> - Opojë, Kosovë), luftën e së mirës kundër së keqes (dukuri kjo që, në variante të ndryshme, haset në folklorin e shumë popujve të Evropës) etj. Edhe disa veprime lodruese fëmijësh që kanë të bëjnë me lutje për të rënë shi, siç është p.sh. "Dordoleci i thatësirës"<sup>15</sup>, apo për mbledhjen e luleve ("Kërcimi ritual i luleve"<sup>16</sup> - Tropojë), përfshinë në kërcimet rituale. Atmosferë ritualistike përfitojnë gjithashtu kërcimet në formë lodruese rreth zjarrit (në festën e Shëngjergjit), të cilat tek ne, ashtu si në popuj të tjerë të Evropës, mund të vështrohen si valle rituale të lashta të lidhura me kulte pagane. Po kaq të lashta janë edhe vallet që përgjithësisht luhen në rreth të mbyllur, formacion që parakupton kërcimin rreth një objekti kulturi (vallja "Moj e hollë moj e g'jatë"<sup>17</sup> - Zadrimë, etj.). Valle të tilla janë praktikuar

kryesisht me ndjelljen e një prodhimit të bollshme dhe të dytat shprehin kënaqësinë për një prodhimtari të tillë

11 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.71/7.88/9.

12 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.71/7.88/9.

13 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.71/3; 97/6; 83/3,142/4.

14 AIKP, përkatësisht, Kf. nr.71/3; 97/6; 83/3; 142/4.

15 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.71/3; 97/6; 83/3, 142/4.

16 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.71/3; 97/6; 83/3;142/4.

17 AIKP, Kf.nr.12/1.

në raste festash të karakterit shoqëror e familjar si: dita e verës, rusicat, daulinat e pranverës, llazoret etj. Lidhur me këto të fundit, nuk mund të lemë pa përmendur "Festën rituale të llazarevë" (në përgjithësi me zakone pagane), ku vallet, të ekzekutuara nga "llazarët" me maska në fytyrë, zinin vend të rëndësishëm. Këto praktika kërcyese kanë qenë të njohura në disa krahina të Shqipërisë së Jugut, p.sh., në Lunxhëri ("Vallja e llazarevë"<sup>18</sup>).

Me ceremonialin e dasmës lidhen edhe disa valle të cilat, herë më pak e herë më shumë, kanë në përmbajtjen e tyre elemente ritualistike. "Vallja e brumit" që luhet në dasmë, p.sh. përbën një ritual për lidhjen bashkëshortore të çiftit të ri. Prandaj disa valle të një natyre të tillë i kemi grupuar në këtë ndarje<sup>19</sup>.

3. - *Vallet lirike të dasmës*. Në këtë grup përfshihen të gjitha vallet, që, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërrhörtë, i bëjnë jehonë ceremonialit të dasmës. Koha e dasmës<sup>20</sup> përcillet me këngë e valle duke i përngjarë një spektakli popullor në formën e një shfaqjeje artistike të organizuar. Përmbajtja e valleve, në të shumtën e rasteve, shtjellohej në përshtatje me çaste të ndryshme të ceremonialit të dasmës. Kësisoj, ka valle të veçanta për fillimin dhe mbylljen e ceremonialit të dasmës. Për fillimin përmendim vallen e grave "L'shoni rrug' l'shoni mejdan"<sup>21</sup>, që, në variante të ndryshme, praktikohet në disa zona të Shqipërisë së Veriut dhe të Kosovës. Rol të veçantë këtu luan mjedisi i grave, të cilat ftojnë për të vallëzuar një nga të pranishmet. Përgjithësisht, kërcimi ka karakter të qetë, por me një farë krenarie, që ndihet edhe në përmbajtjen e tekstit të këngës shoqëruese i cili, për të joshur ekzekutuesin në kërcim, i thur asaj gjithfar "lavdesh". Për mbylljen e dasmës shembulli tipik janë "Vallet e zileve"<sup>22</sup>, të qytetit të Tiranës dhe përgjithësisht të Shqipërisë së Mesme. Ndryshe nga rasti i parë, kërcimi në këto valle karakterizohet nga gjallëria e festiviteti, që nxiten edhe nga ngacmimet e shumta të të pranishme përreth ndaj pjesëmarrësve në valle.

Për llojin e valleve lirike të dasmës, interes të dukshëm paraqesin sidomos ato kërcime që kanë si figurë kryesore vetë nusen. Në disa zona të Shqipërisë së Jugut, për shembull, këto lloj krijimesh, të ashtuqujtura "valle nusesh" - luhet në grup me nusen në "ballin" e valles. Një karakteristikë dalluese për to përbën masiviteti në ekzekutim. Të pranishmit gjatë një dasme, nuk mund të konceptonin shtjellimin e festës pa marrë pjesë gjerësisht në valle, në një grup të madh ose në disa grupe të vogla.

Nga pikëpamja estetike, ndoshta më tepër se llojet e tjera vallet e dasmës

18 AIKP, Kf.Nr.32/1 (nën titullin - Festa tradicionale e Llazarevës.

19 Në qerthullin e valleve rituale zgjon interes "Vallja e lehonës". (Elbasan) për të cilën G.Weigand (Alb.Grain in Sudgçgiche dialekt - 1913 f.154) shkruan se ka qenë praktikuar një shekull më parë (Cituar sipas "Folklor shqiptar", tekst për Universitetin, Tiranë, 1972, f.132).

20 Edhe në çaste të tjera të ceremonialit të dasmës vallet zenë një vend të dukshëm. Çaste të tilla janë: ritet e fejesës; përgatitjet e druve, të miellit, të brumit; ardhja e miqve; të treguarit e pajës; venia e kënasë; veshja e nuses; rruarja e dhëndrit, nisja dhe kthimi i krushqve; venia e nuses në valle; mbyllja e dasmës dhe gostitë që bëheshin pas martesës

21 AIKP, përktësisht, Kf.nr.7/4 (fshati Radavc, krahina e Podgorit - Kosovë); 173/6.

22 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.7/4 (fshati Radavc, krahina e Podgorit - Kosovë); 173/6.

shquhen për elegancë, për një linjë shtjellimi të pandryshuar nga fillimi deri në fund, përgjithësisht me shtrirjen horizontale. Interpretimi i tyre karakterizohet nga nota optimiste, festive dhe një forcë e brendshme, duke transmetuar te të pranishmit një ngarkesë emocionale të ngrohtë. Bashkëveprimi i mjeteve shprehëse koreografike me ato poetiko-melodike është shumë i ndjeshëm dhe funksional në këto krijime (vallja "Nusja jonë arbërore"<sup>23</sup> - Lunxhëri, rrethi Gjirokastrës). Tekstet poetike të valleve të kënduara janë dendur edhe me përmbajtje erotike, gjë që vetvetiu ndikon në atmosferën e theksuar lirike të mjeteve shprehëse koreografike. Në karakterin monumental dhe atmosferën tërësore emocionale të tyre ndikojnë edhe *kostumet popullore*. Hijeshia e tyre, me atë larmi ngjyrash e ornamentesh dekorative sipas krahinave përkatëse, harmonizohet bukur me plasticitetin e zhdërvjelltësinë, me elegancën e të kërcyerit.

Së fundi, në lirikat e ceremonialit të dasmës mund të përfshihen edhe ato valle që kanë përgjithësisht karakter të gëzueshëm e festiv dhe që, nga ana tjetër, në një masë të konsiderueshme, qëndrojnë më larg llojeve të tjera të lirikës ("Lujke Mara lujke Rusha"<sup>24</sup> - Rugovë Kosovë; "Vallja jonë valë-valë"<sup>25</sup> - Zagori, rrethi Gjirokastrë etj.). Gjithashtu, gjatë dasmës luhen edhe valle humoristike, valle pantomime, valle erotike, valle epike etj., të cilat po ashtu mund të praktikohen në të gjitha festat e tjera familjare e shoqërore, duke përfshirë edhe veprimtaritë folklorike.

**4. Vallet lirike erotike.** Për analogji me këngët e dashurisë ku populli i këndon bukurisë së vajzës, ndjenjave dhe virtyteve të saj të pastra, malli që ka për të etj., edhe në vallet erotike, ndonëse të pakta në numër, mishërohet etika e pastër popullore, ndjenja e thellë njerëzore, bukuria morale. Erotika pasqyrohet pa elemente sensualizmi, sentimentalizmi e pesimizmi: në këto valle shprehet dashuria e pastër midis vajzës e djalit nuses e dhëndrit, gruas e burrit. Në këtë lloj të vallëzimit tonë popullor karakteri erotik priret më tepër nga një lirikë-shoqërore optimiste dhe e gëzueshme.

Në vallet erotike, marrëdhëniet midis dy valltarëve, vajzë-djalë, janë si të thuash të një karakteri të brendshëm, me një forcë depërtuese emocionale. Për vetë përmbajtjen e tyre, në këto valle hera-herës vërehen veprime e kundërveprime të një karakteri dialogjik impresionues nga të dy valltarët, duke krijuar kështu plane kontrastuese estetike të larmishme në arkitekturën e kërcimit. Në këto lloj vallesh, krahas karakterit të përgjithshëm lirik, mbizotëron gjerësia, dliresia dhe poezia e motiveve dhe e lëvizjeve koreografike, një farë fisnikërie në të kërcyer. Sipas strukturës së tyre, tek djali spikat forca e temperamentit, ndërsa tek vajza - lirizmi e poetika kërcyese.

Tipin më të kristalizuar të valleve lirike erotike e përbëjnë ato krijime që nuk shoqërohen me muzikë, të cilat vijnë nga shtresëzimet më autentike të kulturës së moçme shqiptare ("Kërcimi i logut"<sup>26</sup> - Malësi e Madhe). Po

23 AIKP, Kf.nr.31/2.

24 AIKP përkatësisht, Kf.nr.89/9 86/11.

25 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.89/11.

26 AIKP; përkatësisht, Kf.nr.8/1; 93/10; 173/5; 132/10.

aq autentike janë edhe disa valle të tjera, me shtrirje mbarëshqiptare ("Vallja e Shotës"<sup>27</sup> - Kosovë: "Vallja e Napolonit"<sup>28</sup> - qyteti i Tiranës; "Pëllumbesha dhe skifteri"<sup>29</sup> - Mirditë etj.). Nga pikëpamja arkitektonike, këto valle i përshkon një strukturë e lirë kërcimi, që i lë fushë veprimi aftësisë krijuese, improvizimit, fantazisë dhe temperamentit të interpreteve. Mënyra kërcyese e disa prej krijimeve të tilla përbën një stil koreografik të qenësishëm për një pjesë të mirë të valleve dyshe të ekzekutuara nga një vajzë e një djalë, të cilët luajnë të shkëputur njëri me tjetrin.

Në koreografinë tonë popullore elemente apo grimca erotike mund të vërehen edhe në valle të llojeve të tjera të lirikës, të cilat luhen nga dy valltarë, vajzë-djalë. Në to, sado pak, nëpërmjet lëvizjeve dhe figurave koreografike, shprehen në një farë mënyre edhe marrëdhënie intime, ku përftohet një atmosferë e theksuar lirike. Gjithashtu, po të kemi parasysh faktin që në folklorin tonë një pjesë e mirë e këngëve të dashurisë praktikohen me valle, atëherë vetvetiu do të pranojmë që një farë mase këto krijime shtojnë numrin e valleve lirike erotike.

**5. Vallet lirike humoristike.** Humori në vallet e këtij lloji qëndron në radhë të parë në plastikën koreografike; me hapa përgjithësisht të thyer, herë-herë me ulje të thella, të një plani më pak horizontal e më shumë vertikal; me një zhdërvjelltësi trupore, ku mbizotërojnë kthesat e valëzuara dhe rrotullimet e theksuara; me lëvizje të shumta duarsh, të një karakteri të gjallë, ku nuk mungojnë edhe përpjekje për një komunikim sa më të afrueshëm. "Vallet për të qeshur", siç i cilësojnë shpesh bartësit, sipas fabulës që trajtojnë, paraqiten disaplanesh. Nëpërmjet gazit e optimizmit, frymëzimit e forcës shprehëse, valle të tilla mishërojnë një përmbajtje ideoemocionale liriko-humoristike (vallja "Rashë e theva shtambënë"<sup>30</sup> - Zagori) Nga ana tjetër, nëpërmjet një humori therrës popullor, ato shprehin protestë ndaj shoqërisë, duke marrë kështu edhe një përmbajtje shoqërore (Vallja "Burri i vogël, moj kërcurë"<sup>31</sup> - Vërçë, rrethi i Gramshit). Në plastikën koreografike të tyre ndodh që elemente humoristike mpleksen me elemente komike ("Vallja e Xhixhlesë" - Myzeqe). Në ndonjë rast, duke u ndërthurur humori me satirën krijohet një mjedis i gëzueshëm, por edhe ironizues. ("Vallja e Totës"<sup>32</sup>, rrethi i Përmetit). Në raste të tilla, kemi të bëjmë më tepër me parodizime humoristike. Ndonjëherë në krijimet e këtij lloji humori ia le vendin një satire të fortë shoqërore (vallja "Abaz Aga don me ardhë"<sup>33</sup>, Fshatrat e Fushës, rrethi i Tiranës). Nuk mungojnë rastet që në valle të ndryshme ironia, sarkazma, grotesku, parodizimi etj., shkrihen pjesërisht ose tërësisht, çka u jep krijimeve të këtij lloji një forcë të veçantë shprehëse.

27 AIKP, përkatësisht, Kf.8/1; 93/10; 173/5; 132/10.

28 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/1; 93/10; 173/5; 132/10.

29 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/1; 93/10; 173/5; 132/10.

30 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.86/12; 65/6; 24/7.

31 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.86/12; 65/6; 24/7.

32 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.86/12; 65/6; 24/7.

33 AIKP, Kf.nr.116/10.

Dallimi i këtyre valleve nga vallet e tjera qëndron tek gërshetimi i kërcimit me gjestin, me mimikën, me këngën dhe, herë-herë, edhe me fjalën, të gjitha të veshura me elemente humoristike, komike dhe satirike, të veçanta ose të përbashkëta.

Karakteri improvizues është një nga tiparet më të qenësishme të valleve humoristike. Shtjellimi i fabulës, veç një bërthame të përhershme, qëndron edhe tek spontaniteti i lojës së valltarëve popullorë. Kjo është arsyeja që plastika kërcyese përgjithësisht me fizionimi të zhdërvjellët dhe dinamike, nuk është krejtësisht e përcaktuar, por në varësi të forcës interpretuese të valltarëve, gjithmonë brenda shtratit të fondit koreografik krahinor. Për vetë përmbajtjen dhe strukturën e kërcimit, këto krijime kërkojnë mjeshtër të zot si valltarë këngëtarë dhe humoristë ose hokatarë, siç i cilësojnë në shumë krahinë. Në disa valle në grup, personazhin kryesor të fabulës shpeshherë e simbolizon i pari i vargut, "balli". Madje, në disa valle humoristike dialogu zhvillohet midis "ballit" dhe grupit të valltarëve. Skena dialogu kryhen edhe midis interpretuesve dhe mjedisit përreth. Në raste të tilla këto valle marrin një karakter të theksuar spektakular, si dhe funksion estetiko-artistik të madh, që rrëmben të pranishmit përreth, të cilët ndjekin me vëmendje lojën dhe, njëherësh, ndërhyjnë me shpotitje e nxitje hera-herës me anë të këngës. Faktorë të tillë bëjnë që vallet humoristike satirike apo komike të luhen veçanërisht kur "ndizet dasma" ose në kulminacionet e çfarëdo feste familjare dhe shoqërore. Prandaj ato gëzojnë popullaritet të madh si në rrafsh krahinor, ashtu edhe kombëtar.

Në vallet humoristike, ndofta ndryshe nga llojet e tjera të lirikës, ka të tilla, siç është, për shëmbull "Vallja e Xhafer Kabës"<sup>34</sup> (Dibër), që lidhen me një emër të caktuar, i cili ka dhënë drejtpërdrejt ndihmesë për lindjen kristalizimit dhe përhapjen e valles. Pra, valle të tilla kanë pasur një fillesë krijuese individuale, që, dalëngadalë, nga përmbajtja e veçantë ideoemocionale, thjeshtësia kompozicionale dhe forca e madhe komunikuese, kanë fituar tiparet e krijimeve folklorike kolektive. Për natyrën e tyre këto kërcime ruajnë një karakter të gjerë shoqëror.

6. *Vallet lirike pantomimë*. Disa nga argëtimet dhe zbavitjet folklorike, që vetë populli në shumë krahina i quan "lodra", kanë, ku më shumë e ku më pak, edhe elemente fillestare të kërcimit popullor. Nga ana tjetër, këto shfaqje shpesh gërshetohen me elemente të dramaturgjisë popullore, si dhe me pantomimën, si pjesë përbërëse e folklorit dramatik. Ky gërshetim i argëtimit (dhe i elementeve të kërcimit) me pantomimën ka krijuar në fushën e lirikës koreografike një lloj të veçantë - argëtimet koreopantomimike apo *vallet pantomimë*.<sup>35</sup> Në të shumtën e rasteve, vallet pantomimë, nëpërmjet elementeve parodizuese, replikave të mprehta, atmosferës gazmore e thumbuese etj., fshikullojnë zakone dhe vese prapanike. Në thellësinë e fabulës së këtyre valleve spikat urtësia dhe mendimi filo-

34 AIKP, Kf.52/1 (me titull Vallja e Xhafer Kabës dhe kërcimi i rand' i Lurës).

35 Më gjerë për këtë shih: R.Bogdani; Vallet pantomimike si një fushë e rëndësishme e koreografisë popullore dhe funksioni i tyre; "Studime filologjike", Tiranë, 2/1977, f.133-132.

zofik i popullit, ndërgjegjja e tij artistike. Elementet ritualistike të një natyre primitive që gërshetojnë hera-herës vallet pantomimë dëshmojnë njëherësh lashtësinë e tyre. Elementet liriko-rituale, humoristiko-kimike dhe tragjiko-dramatike shpesh shkrihen organikisht duke krijuar një plastikë koreografike me thellësi mendimi, të aftë për të zbërthyer idenë e fabulës dhe për të komunikuar me vërtetësi e origjinalitet me shikuesit. Vallet pantomimë përshkohen nga nota të çiltra e gazmore, me humor të gjallë popullor. Një dukuri e tillë bën që, në aspektin krijues dhe interpretues, dallimi midis valleve pantomimë dhe atyre humoristike të jetë më i vogël se në çdo lloj tjetër të lirikës koreografike shqiptare. Vetëm një analizë strukturore e hollësishme mund të përcaktojë tiparet më të qenësishme të të dy llojeve përkatëse.

Vallet pantomimë gëzojnë popullaritet të madh. Ndonjë nga këto krijime, për shembull, si "Plaku i dasmës"<sup>36</sup> (fabula godet martesën e plakut me një nuse të re ose të burrit me dy gra) ka shtrirje mbarëkombëtare, gjë që shprehet edhe në emërtimet e saj: "Xhambazi", "Buçi", "Fatimja", "Xhixhileja", "Dervishi". "Maxhypi", "Sharaleja". "Harapesha" etj. Ka krijime të tilla, si "Ojna e lepurit"<sup>37</sup>, që vetë bartësit i kanë shkarkuar nga përdorimi i ndonjë bestytie, si dhe nga ndonjë element patriarkal, duke mbajtur kështu qëndrim kritik ndaj fenomeneve negative. Nga ana tjetër, nuk janë të pakta vallet pantomimë me karakter thjeshtë zbavitës ("Loja e kapuçave"<sup>38</sup> - Rugovë, Kosovë etj.).

Këto krijime, sa të lashta aq edhe bashkëkohore, për vetë specifikën e tyre, praktikohen sidomos në dasmë, në orët e vona të natës, pasi janë ekzekutuar këngët e vallet, duke krijuar kulminacione të tjera në tërësinë e gëzimeve të dasmës. Disa prej tyre (kryesisht "Plaku i dasmës"), duke u ekzekutuar veç nga gratë e veç nga burrat (te gratë, rolin e burrave e luanin ato vetë, ndërsa te burrat rolin e grave e luajnë burrat) krijojnë një atmosferë të veçantë humorit. Për sa i përket strukturës, në vallet pantomimë, më shumë se kudo gjetkë, veç një shtjellimi të caktuar sipas fabulës, luan rol edhe spontaniteti e improvizimi. Nga pikëpamja morfologjike këtu spikasin tipare të tilla të qenësishme e origjinale si: imitime të formave të kërcimit dhe të pantomimës, lëvizje vallëzuese si të thuash në mënyrë recitative, veprime koreografike me karakter të theksuar plastiko-humoristik, mjete shprehëse të artit dramatik (është i pranishëm edhe sikuri dramatik), mizanskena me gjeste dhe gjestikulacione plastiko-koreografike etj. Ajo që i dallon së tepërmi këto krijime është sinkretizimi i mirëfilltë folklorik; në to shkrihen harmonikisht elementet e kërcimit, të pantomimës dhe të folklorit dramatik, në unitet e bashkëveprim artistik me elementet poetike e muzikore. Në këtë simbiozë artistike, një rol të veçantë luajnë të pranishmit përreth. Ata krijojnë shpeshherë skena dialogu me ekzekutuesit, duke forcuat këssoj atmosferën zbavitëse dhe spektakulare të tyre.

36 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.16/3 (Lumë - Kukës); 42/6.

37 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.26/3 (Lumë - Kukës); 42/6.

38 AIKP, Kf.90/5.

Në këtë lloj të lirikës koreografike mund të përfshihen edhe ato pak krijime në të cilat spikatin veprime parodike për imitim e kafshëve, shpendëve dhe të insekteve ("Vallja e kaprollit" - Myzeqe; "Ojna e lepurit" - fshati Hotolisht, rrethi i Librazhdit, "Ojna e iriqit"<sup>39</sup> - Kosovaret e fshatit Rreth - Libofsh, rrethi i Fierit. "Loja e dashit"<sup>40</sup> - fshatrat e rrethit të Durrësit; "Deshtë vrastorë"<sup>41</sup> - zona e Gashit rrethi i Tropojës, "Vallja e lejlekut" - Krahina e Fushës, rrethi i Krujës, "Vallja e bletës"<sup>42</sup> - Lumë, rrethi i Kukësit).

**Vallet epike.** Patosi heroik dhe fryma luftarake, si veti të vyera të popullit shqiptar, u përcollën brez pas brezi nëpër shtigjet e historisë, duke lënë gjurmë edhe në kulturën tonë popullore në përgjithësi dhe në këngët e vallet në veçanti. Vallet epike, me atmosferën, fabulën dhe plastikën koreografike, sjellin jehonën e ngjarjeve historike të së kaluarës, përpjekjet dhe luftërat e popullit tonë për liri...

Vallet epike bartin tipare karakteristike të psikologjisë, të botëkuptimit e të temperamentit të popullit tonë, të krijuara nën ndikimin e rrethanave historike, të kushteve ekonomiko-shoqërore, mjedisit gjeografik shqiptar etj. Në to shihen forca, burrëria, trimëria, karakteri luftarak etj; ato mbartin një frymë të gjallë dinamike dhe optimiste. Fabula e tyre karakterizohet nga patosi epiko-heroik dhe figura artistike monumentale.

Vallet epike, me shtratin kërcyes etnik, me përmbajtjen ideoemocionale, me larminë e mjeteve koreografike, me interpretimin e lartë artistik etj., ruajnë origjinalitet etnokulturor dhe kanë vlera të mëdha ideoestetike. Në këtë mënyrë ato paraqesin interes të dorës së parë për etnokoreografinë popullore në veçanti dhe folkloristikën shqiptare në përgjithësi. Njëherësh ato hedhin dritë në lashtësinë e kulturës sonë kombëtare. Vallet epike shquhen për vitalitet e ekspresivitet, për zhdërvjelltësinë dinamike të burrave, për elegancën hijerëndë të grave.

Këto valle kanë nëndarjet apo llojet e veta, të cilat janë më të pakta se ato të valleve lirike. Plastika koreografike e tyre, ndonëse e kursyer dhe e ngjeshur, ka një përfytyrë dalluese ku spikat sidomos dinamika. Në koreografinë popullore mund të bëhet fjalë për dy lloje vallesh epike. Të parat, *vallet luftarake*, janë më të qarta dhe më konkrete. Në to valltarët kërcëjnë me armë. Lloji i dytë, *vallet trimërishte*<sup>43</sup>. Një emërtim i tillë i përafërt haset në popull, (në të cilat përfshihen edhe vallet kaçakçe), është më e vështirë për t'u përcaktuar. Në to përjetohen ngjarje me një frymë të përgjithshme luftarake dhe nëpërmjet kërcimit, mishërohet burrëria, krenaria, madhështia, solemniteti etj.

Të dyja llojet e epikës, ndonëse të përafërta, i diferencojnë përmbajtja emocionale. Ashtu si në poezinë popullore, ku lëngët legjendare janë më të lashta sesa këngët historike, edhe në epikën koreografike shqiptare vallet

39 AIKP, Kf, nr.163/5.

40 AIKP, përkatësisht, kf.nr.155/4, 142/6; 127/10.

41 AIKP, përkatësisht, kf.nr.155/4, 142/6; 127/10.

42 AIKP, përkatësisht, kf.nr.155/4, 142/6; 127/10.

43 Një emërtim i tillë i përafërt haset në popull.

luftarake i bëjnë jehonë një epoke më të hershme. Kurse vallet trimërishte pasqyrojnë ngjarje dhe ndodhi më të vonshme, kryesisht të shekujve të fundit. Pra, vallja epike ka një shtrirje kohore që zë fill qysh në lashtësi e vjen deri në ditët tona.

Vallet epike luhen kryesisht nga burrat dhe më pak nga gratë ose nga burra e gra së bashku.<sup>44</sup> Kur flasim për epikën koreografike nuk mund të lëmë pa kujtuar edhe gjamën tradicionale. (Dukagjini është një ndër vatrën kryesore). Gjama përshkohet nga nota thellësisht tragjike që japin dhembjen e madhe që ka shkaktuar vdekja e njeriut të afërm. Ajo shprehet duke gërshetuar mimikën e zyrtë e plot dëshpërim, me tërë lëvizjet e gjymtyrëve dhe të trupit, me grushtat që godasin ritmikisht gjoksin, me pasthirmat e njerëzve, me hapat sjelejnë, duke krijuar që të gjitha bashkërisht një pamje funebre. Në këtë rit të lashtë duken qartë bulëzat plastiko-rituale me përmbajtje koreografike.

**1. Vallet epike luftarake.** Këto valle paraqesin interes të veçantë për kulturën popullore shqiptare, sepse përbëjnë një traditë të fuqishme etnike<sup>45</sup>. Autorë të ndryshëm si: De Rada, L.M.Talloszy, A.Smileri, zonja Chenier, T.S.Huger, Pukëvili, N.Politis, Hobhouse, etj. në veprat e tyre kanë çmuar fort traditat burrërore e luftarake nëpërmjet përshkrimit të disa valleve me përmbajtje luftarake, të cilat kanë qenë praktikuar në të kaluarën nga shqiptarët.. Prejardhja e ndonjë valleje luftarake ("Premja me tagana" - Malësi e Madhe) mund të lidhet me kushtet shoqërore të rendit fisnor; madje mund të na kujtojë edhe gjurmët e "Valles pirrike" të Greqisë së lashtë, që konsiderohej për kohën si vallja më e mirëfilltë luftarake<sup>46</sup>. Për vazhdimësinë e jetës së "valles pirrike" është vendi të përmendim një të dhënë të humanistit shqiptar Marin Barleti, i cili në librin VII të veprës "Historia e Skënderbeut...", duke folur për fitoren kundër rrethimit të parë të Krujës më 1450, shkruan se, shqiptarët duke pritur Skënderbeun fitimtar, midis shumë argëtive, kërcenin valle pirrike. Vallet e kësaj natyre, me forcën ideoemocionale, bartin skena jetësore, të cilat janë të shumta në epikën tonë heroike legjendare.

Duke u nisur gjithnjë nga përmbajtja, dhe forma artistike, vallet luftarake mund t'i ndajmë në tre grupe. Në grupin e parë bëjnë pjesë vallet e

<sup>44</sup> Kur flasim për epikën koreografike nuk mund të lëmë pa kujtuar edhe gjamën tradicionale. (Dukagjini është një ndër vatrën kryesore). Gjama përshkohet nga nota thellësisht tragjike që japin dhembjen e madhe që ka shkaktuar vdekja e njeriut të afërm. Ajo shprehet duke gërshetuar mimikën e zyrtë e plot dëshpërim, me tërë lëvizjet e gjymtyrëve dhe të trupit, me grushtat që godasin ritmikisht gjoksin, me pasthirmat e njerëzve, me hapat solejnë, duke krijuar që të gjitha bashkërisht një pamje funebre. Në këtë rit të lashtë duken qartë bulëzat plastiko-rituale me përmbajtje koreografike.

<sup>45</sup> Autorë të ndryshëm si: De Rada, L.M.Talloszy, A.Smileri, zonja Chenier, T.S.Huger, Pukëvili, N.Politis, Hobhouse, etj., në veprat e tyre kanë çmuar fort traditat burrërore e luftarake nëpërmjet përshkrimit të disa valleve me përmbajtje luftarake, të cilat kanë qenë praktikuar në të kaluarën nga shqiptarët

<sup>46</sup> Për vazhdimësinë e jetës së "Valles pirrike" është vendi, të përmendim një të dhënë të humanistit shqiptar Marin Barleti, i cili në librin VII të veprës "Historia e Skënderbeut...", duke folur për fitoren kundër rrethimit të parë të Krujës më 1450, shkruan se, shqiptarët duke pritur Skënderbeun fitimtar, midis shumë argëtive, kërcenin valle pirrike

luajtura nga dy veta, që zhvillohen në formë dueli, duke shprehur forcën, trimërinë dhe gjallërinë e një dyluftimi të vërtetë ("Premja me tagana"<sup>47</sup>, "Loja me jataganë"<sup>48</sup>, "Loja me pisqoleta"<sup>49</sup>, Vallja e kësulave", "Hoqa e Prizrenit"<sup>50</sup>). Fundi i valleve të këtij grupi paraqitet në dy variante. Në të parin, njëri nga valltarët del më i fortë (sipas ndonjë kallëzimitari, më i fortë mund të njësohet me Gjergj Eleze Alin, që lufton kundër një armiku të huaj - balozit; - "Premja me tagana", "Loja me jataganë"). Në variantin e dytë, dy luftëtarët bashkojnë shpatat me shokët e tjerë në luftë kundër armikut. Bartësit popullorë, u kanë dhënë valleve një përmbajtje të re, që, siç kuptohet, lidhet me zgjimin e ndërgjegjes kombëtare ("Vallja e kësulave", "Hoqa e Prizrenit"). Vallet e grupit të parë, për vetë përmbajtjen ideoemocionale, karakterin, strukturën dhe kërcimin solistik, paraqesin vështirësi në të interpretuar dhe në të ekzekutuar. Megjithatë, nuk janë të pakët bartësit, edhe nga brezat më të rinj, që i luajnë ato me virtuoizizëm.

Në grupin e dytë të valleve luftarake, që, ndryshe nga të parat, luhen me më shumë se dy veta, bëjnë pjesë ato krijime në të cilat karakteri luftarak shprehet në një mënyrë më të tërthortë, duke i mbajtur valltarët shpatat solemnisht në duar. Valle të tilla sjellin gjendje psikologjike-shpirtërore të valltarëve-luftëtarë para ose pas një beteje ("Këlliçoja e parë"<sup>51</sup> - Lumë, rrethi i Kukësit). Në to, përgjithësisht, mjeti luftarak, shpata, nuk përplasët, ajo vringëllon krenare në dorën e valltarëve. Vallet e këtij grupi, edhe pse me veçori stilistikore të ndryshme nga vallet luftarake të grupit të parë, spikasin për bukurinë e krenarinë e interpretimit. Këto valle shquhen për një farë organizimi artistiko-estetik në lëvizje dhe figura, ndërsa spontaniteti është i kufizuar. Vallet përgjithësisht luhen qetë, me shtrirje horizontale, por dallohen për një dinamikë të brendshme me karakter të theksaur patetik, me një plastikë të pasur e të zhdërvjellët. Kësisoj, ato sjellin shpesh nota epike poetike.

Në grupin e tretë të valleve luftarake bën pjesë ndonjë valle e arbëreshëve të Italisë<sup>52</sup>, e luajtur në grup, e cila krahas përmallimit për atdheun e largët, Shqipërinë, evokon figurën, luftërat e heroit tonë kombëtar, Gjergj Kastriotit kundër pushtuesve osman. Vallet që i kushtohen këtij evokimi kanë si tipar karakteristik ndërthurjen e elementëve të kërcimit me veprime pantomimike folklorike tradicionale. Këto valle kanë më së shumti karakter ceremonial, që duket në ndonjë rast në përdorimin e flamurit kombëtar, të armëve etj. Ato jetojnë kryesisht në kujtesën e të moshuarve dhe në ndonjë variant, praktikohen në raste gëzimesh popullore.

Me kohë studiuesit kanë vënë në dukje edhe karakterin luftarak të disa

47 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/11; 90/1; 91/1; 74/4; 74/4; 51/1.

48 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/11; 90/1; 91/1; 74/4; 51/1.

49 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/11; 90/1; 91/1; 74/4; 51/1.

50 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.8/11; 91/1; 74/4; 51/1.

51 Arkivi i Filmit i Televizionit shqiptar (Revista e folklorit burimor të Kosovës - Glligovc, 1989).

52 AIKP, Kf.nr.84/10 (vallja e kënduar "E kush ja tha sat" ëme").

valleve arbëreshe;<sup>53</sup> A.Skura gjithashtu, flet për vallen e lashtë pirrike që praktikohej ndër arbëreshët. Me mjaft interes janë edhe të dhënat e sjella vitet e fundit mbi një valle që interpretohej me veshje e maska që paraqesin "ushtarët e Skënderbeut, që fitojnë mbi armikun"<sup>54</sup>. Sipas etnografit arbëresh E.Xhordano, kjo valle paraqet kthimin e ushtrisë së Skënderbeut në Krujë pas fitores së parë kundër turqve në afërsi të Dibrës, në pranverë të vitit 1444<sup>55</sup>. Kjo valle, që luhet në fshatrat arbëreshe Frasnitë dhe Ejaninë të Kozencës - Kalabri, vitet e fundit është bërë me e njohur në ngulimet arbëreshe<sup>56</sup>.

Rastis që, në vend të armëve, vallet luftarake të luhen edhe me shkopinj, shami etj. (Vallja "Këlliçoja e dytë"<sup>57</sup> - Lumë rrethi i Kukësit). S'mungojnë as vallet në të cilat, edhe pse nuk përdoret mjete luftarak, vepron dyluftimi me forcën e krahëve ("Vallet dyshe burrash"<sup>58</sup> - Deçan, Kosovë), Në krijime të tilla, plastika koreografike dhe përgjithësisht mjetet shprehëse artistike, veprojnë me aq forcë, saqë, në një farë mase, krijojnë një tip kërcimi të mëvetshëm brenda valleve luftarake. Po ashtu, nocioni për vallet e mirëfillta luftarake do të merrte përmasa më të gjëra, nëse do të përfshiheshin edhe disa krijime, të cilat, siç e tregon deridiku edhe titulli, ka të ngjarë të përfytyrojnë armën ("vallja e Martinës"<sup>59</sup>, "Havaja e thikave"<sup>60</sup>.) Të një natyre të tillë, që lidhen me ngjarje luftarake, mund të konsiderohen edhe valle të tjera ("Valle Zebekshe"<sup>61</sup>, "Valle nizamçe", "Valle Kasarpe").

Siç vihet re, vallet luftarake kanë qenë më të shumta, dhe, mbi të gjitha, me një përmbajtje ideoemocionale dhe stilistike kërcimi të pasur.

2. - **Vallet epike trimërishte.** Në këto krijime përmbajtja ideoemocionale shpreh herë protestë, herë urrejtje, herë qëndresë, aty-këtu një çast beteje, apo një moment heroik. Pra, në to krijuesi popull ka përjetuar historinë e vet. Ato përshkohen nga një frymë e gjallë, janë tepër dinamike dhe optimiste, prandaj kërkojnë forcë fizike dhe shpirtërore të madhe në interpretim. Artistët popullorë që i luajnë ato i shquan një qëndrim serioz e krenar. për analogji me përmbajtjen ideoemocionale, edhe në vështrimin morfologjiko-strukturor të plastikës koreografike dhe përgjithësisht të mjeteve shprehëse artistike, te këto valle spikat zhdërvjelltësia dhe vru-llëzimi i kërcimit, por me një fizionomi, specifike - dinamike të brendshme impulsive. Vallet trimërishte, me tiparet dhe veçoritë e veta krahinore,

53 Dora D'Istra, Kombësia shqiptare pas këngëve popullore.

54 Gj.Shkurtaj, Shpirti i arbërit rron, Tiranë, 1984, f.103.

55 Cit.sipas Gj.Shkurtajt, po aty, f.103.

56 Gj.Shkurtaj, po aty, f.103.

57 AIKP. Kf.nr.15/2.

58 Arkivi i Filmit të Televizionit Shqiptar. (Revista e folklorit burimor të Kosovës - Gillogovc 1978).

59 AIKP, përkatësisht Kf.nr.43/2 (fshati Labinot-Fushë, Çermenikë, rrethi i Elbasanit); 72/12 (Librazhd); 22/6 (Guri i Bardhë, rrethi i Matit).

60 AIKP, përkatësisht Kf.nr.43/2 (fshati Labinot-Fushë, Çermenikë, rrethi i Elbasanit); 72/12 (Librazhd); 22/6 (Guri i Bardhë, rrethi i Matit).

61 AIKP. përkatësisht Kf.nr.43/2 (fshati Labinot-Fushë, Çermenikë, rrethi i Elbasanit); 72/12 (Librazhd); 22/6 (Guri i Bardhë, rrethi i Matit).

interpretuese etj., i gjejmë në çdo krahinë të vendit dhe kërcehen nga gjithë brezat.

Në vallet trimërishte, siç u vu në dukje më lart, bëjnë pjesë edhe të ashtuquajturat *vallet kaçakçe*, të cilat më tepër se në tjerat, e marrin pikënisjen në rrjedhën e ngjarjeve historike të shekujve të fundit. Ndër to, aty-këtu, mund të gjejmë, jehonën e kryengrijteve fshatare të Tanzimanit të viteve 1831-1874 që shpërthyen në Dibër, Malësi të Gjakovës, Prizren, Labëri, Delvinë, Gjakovë etj. Edhe periudhat e mëvonshme historike flasin për gjurmë të valleve trimërishte, të tipit kaçakçe. E tillë është për shembull. "Vallja e Vitisë"<sup>62</sup> së Karadakut të Moravës së Epërme. Sipas burimeve gojore, variante të ndryshme të kësaj valleje njihen edhe në krahina të tjera të Kosovës si dhe nga shqiptarët e Maqedonisë e të Malit të Zi. Vallet kaçakçe kanë një shtrirje shumë të gjërë. Ato ekzistojnë në variante të ndryshme të tyre në pika të caktuara të Fushës së Korçës<sup>63</sup>, Myzeqesë, Dumresë, Çamërisë<sup>64</sup>. Në strukturën e kërcimit të valleve kaçakçe hasen edhe elemente pantomimike apo teatralo-dramatike tek të cilat kanë përparësi ecjet dhe qëndrimet monumentale. Mbase janë këto dukuri që u japin kërcimeve një natyrë recitative.

Ka edhe valle të tjera, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë sjellin jehonën e çetave patriotike që luftonin për liri gjatë fillimit të shekullit tonë. Ato mund të janë përfytyrime të ngjarjeve luftarake, por edhe krijime që tregojnë për gjendjen shpirtërore të luftëtarëve. Këtu nuk është fjala për tekstin e poezisë popullore (në vallet e kënduara) që bart këtë ide, por, kryesisht, për strukturat e kërcimit dhe, në një farë mase, për fabulat e tyre. Në këtë drejtim shumë nga vallet tona epike mund të përcaktohen si valle trimërishte. Përmendim kështu vallet dyshe të burrave Toskë<sup>65</sup>, Çame<sup>66</sup>, Myzeqare<sup>67</sup> të cilat shoqërohen me këngë polifonike. Në vallet trimërishte mund të përfshihen gjithashtu vallet labe të burrave<sup>68</sup> si

62 Arkivi i Filmit i Televizionit shqiptar (Revista e folklorit burimor të Kosovës - Gllogovc 1980).

63 AIKP, Kf.157/6 (pjesa e parë e "Kaçakçe dhe vallja e Kapos). Në këtë rast, vallja, duke u ringjallruar sipas pantomimës folklorike tradicionale vendase, u paraqit nga grupi i Korçës në Festivalin Folklorik Kombëtar - Gjirokastër. 1983.

64 AIKP, Kf.nr.69/9 ("Valle çamçe kaçakçe").

65 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.65/3 ("Vallja "Buçet zëri Shqipërisë"; 25/5 (Vallja "Shqipëri je balli nderit" - Myzeqe, rrethi Fier); 166/10 (Vallja "Korrak' e zeza Korrak' - Bolenë, Kurveleshi i poshtëm rrethi - Vlorë); 154/7 ("Valle burrash Çame" - Konispol, rrethi Sarandë).

66 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.65/3 ("Vallja "Buçet zëri Shqipërisë" - Gramsh), 111/3 ("Vallja Osman Takes" - Konispol, - Gramsh), 111/3 ("Vallja Osman Takes" - Konispol, rrethi Sarandë; 25/5 (Vallja "Shqipëri je balli nderit" - Myzeqe, rrethi Fier); 166/10 (Vallja "Korrak' e zeza Korrak' - Bolenë, Kurveleshi i Poshtëm, rrethi - Vlorë); 154/7 ("Valle burrash çame" - Konispol, rrethi Sarandë).

67 Për secilën referencë po sjellim nga një shembullvallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht; Kf.nr.65/3 ("vallja zëri Shqipërisë" - Gramsh), 111/3 ("Vallja Osman Takes" - Konispol, rrethi i Sarandës 25/5 (Vallja "Shqipëri je balli nderit" - Myzeqe, rrethi Fier); 166/10 (Vallja "Korrak' e zeza Korrak' - Bolenë, Kurveleshi i Poshtëm rrethi - Vlorë; 154/7 (Valle burrash çame" - Konispol, rrethi Sarandë).

dhe ndonjë krijim çamë,<sup>69</sup> luajtur nga burrat, që ekzekutohen në grup. Kërcimi këtu lidhet kryesisht me valltarin e parë, i cili shquhet për zhdërvjelltësi plastike dhe përgjithësisht për virtuoizizëm në ekzekutim. Është sidomos ky valltar, që me botën dhe individualitetin e tij krijues, me lëvizjet e lira, prin në valle dhe krijon figura koreografike të një karakteri patetiko-heroik.

Krijime epike trimërishte janë edhe vallet dyshe të burrave, të shoqëruar me curle e lodra<sup>70</sup>, që në disa lloje e variante luhen në shumë krahina, si dhe mjaft nga vallet e burrave të krahinave të ndryshme të Shqipërisë. Të tilla janë kërcimet njëshe të burrave të trevave veriore<sup>71</sup>, veriperëndimore<sup>72</sup> dhe verilindore<sup>73</sup> të vendit që luhen edhe në Kosovë e nga shqiptarë të tjerë. Ato zenë vend të madh në koreografinë tonë popullore. Përmbajtja ideoemocionale epike e tyre lidhet më shumë me patosin heroik e frymën trimërore. Nëpërmjet këtyre kërcimeve krijohen përfytyrime estetike mbi figura të shquara të udhëheqësve të kryengritjeve popullore. Po ashtu, një përfytyrim të tillë japin edhe vallet trimërishte të periudhave të mëvonshme historike deri në ditët tona.

Ndonëse më të kufizuara se ato të burrave, ka edhe valle grash, të cilat, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë, shprehin tipare të një kërcimi dinamik e ekspresiv, me një patos epik heroik, që mund të cilësohen si valle trimërishte. Jehonën e një karakteri epik sjellin përgjithësisht vallet labe të grave të kërcyera në dy grupe gjysmërrathësh (vetë ekzekutueset e quajné lashtërishte)<sup>74</sup>, një kërcim i Dragobisë (Tropojë), i quajtur "Kërcimi i sokoleshës" etj.

68 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara; AIKP, përkatësisht; Kf.nr.65/3 ("vallja Osman Takes" -Konispol, rrethi Sarandës, 25/5 ("Vallja "Shqipëri je balli ndërit" - Myzeqe, rrethi Fier); 166/10 (Valle "Korrak' e zeza Korrak' - Bolenë, Kurveleshi i Poshtëm, rrethi - Vlorë); 154/7 ("Valle burrash Çame" - Konispol, rrethi Sarandë.

69 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.65/3 ("vallja "Buçet zëri Shqipërisë" - Gramsh), 111/3, ("Vallja Osman Takes" - Konispol, rrethi Sarandës, 25/5 ("Vallja "Shqipëri je balli nderit" - Myzeqe, rrethi Fier); 166/10 (Vallja "Korrak' e zeza Korrak' - Bolenë, Kurveleshi i Poshtëm, rrethi - Vlorë); 154/7 ("Valle burrash Çame" - Konispol, rrethi Sarandë).

70 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.22/2 ("Kadja e parë e vjetër matjane" - Macukull, rrethi Mat); 72/2 ("Kcim burrash tropojane" - rrethi Tropojë; 2/5 ("Valle burrash hasjane" - Has, rrethi Kukës); 7/1 ("Kcim burrash i Radavcit" - Krahina e Podgurit, Kosovë).

71 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara; AIKP, përkatësisht, Kf.nr.22/2 ("Kadja e parë e vjetër matjane" - Macukull, rrethi Mat); 72/2 ("Kcim burrash tropojane" - rrethi Tropojë; 2/5 ("Valle burrash hasjane" - Has, rrethi Kukës); 7/1 ("Kcim burrash i Radavcit" - Krahina e Podgurit, Kosovë).

72 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.22.2 ("Kadja e parë e vjetër matjane" - Macukull, rrethi Mat); 72/2 ("Kcim burrash tropojane" - rrethi Tropojë; 2/5 ("Valle burrash hasjane" - Has, rrethi Kukës), 7/1 ("Kcim burrash i Radavcit" - Krahina e Podgurit, Kosovë).

73 Për secilën referencë po sjellim nga një shembull vallesh të filmuara: AIKP, përkatësisht, Kf.nr.22/2 ("Kadja e parë e vjetër matjane" - Macukull, rrethi Mat); 72/2 ("Kcim burrash tropojane" - rrethi Tropojë; 2/5 ("Valle burrash hasjane" - Has, rrethi Kukës); 7/1 ("Kcim burrash i Radavcit" - Krahina e Podgurit, Kosovë).

74 AIKP, Kf.nr.171/1 (fshati Sasaj, rrethi Sarandë).

Në disa valle, siç u theksua më sipër, rastis që brenda të njëjtit krijim, plastika koreografike të karakterizohet nga ndërthurja e kërcimit të fortë me të butë, të prerë me të shtruar, të shpejtë me të ngadaltë. Në këtë mënyrë, vallja përftohet me nuancime plastike koreografike herë me shtrirje horizontale e herë vertikale. Në këto raste, forca krijuese e artistit popull i ka shkrië elementet e plastikës koreografike lirike me atë të plastikës koreografike epike në atë shkallë, sa është e vështirë të dallohet njëra nga tjetra. Gërshetimi në një valle të vetme i elementeve koreografike lirike me ato epike do të mund të përbente një grupim apo zhanër të tretë: *Valle liriko-epike* dhe *ato epiko-lirike*. Klasifikimi i valleve në liriko-epike dhe epiko-lirike bëhet duke pasur parasysh raportet sasiore midis elementeve të plastikës koreografike lirike dhe atyre të plastikës koreografike epike.

**Vallet liriko-epike.** Në këto krijime mbizotëron atmosfera lirike, kurse epizmi paraqitet si element plotësues. Nga ana koreografike, në to duket çiltërsia, hijeshia dhe eleganca; aty-këtu, plastika koreografike merr një farë natyre të theksuar e të fortë. Vallet e këtij lloji janë të shumta dhe praktikohen si nga gratë, ashtu edhe nga burrat ose së bashku ("Valle bishtore e Labinotit"<sup>75</sup> - Çermenikë, rrethi Elbasan; "Valle burrash të Opojës"<sup>76</sup> - Opojë, Kosovë; "Valle grash çame"<sup>77</sup> - zona e Konispolit - Çamëri, rrethi i Sarandës etj.).

Në vallet popullore lirike vërejmë shfaqjen e një sërë dukurish, si: zbukurimin e ndjeshëm të lirikës, shfaqjen e theksuar të entuziazmit e optimizmit, rritjen e numrit të valltarëve, veçanërisht gjatë ekzekutimit të përzier etj. Madje, duhet theksuar se një vend të rëndësishëm në vallet e kënduara zenë tekstet e reja poetike. Qysh gjatë periudhës së Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare lindën një sërë këngësh, për dëshmorët. Mbi tekstin e këngës për Sofo Meksin, u ngrit vallja partizane aq e populëllarizuar "Lule Sofo, lule djalë"<sup>78</sup>. Në këto valle mbizotëron plastika e qetë dhe e gjerë, çiltërsia dhe eleganca, të cilat i japin kërcimit një patos festivo-optimist. Notat lirike të tyre ndërthuren në një farë mase me një plastikë të gjallë e deri diku të fortë, të një natyre të zhdërvjellët burrërore, ku shquajnë ngjyrat epike. Kësisoj, këto krijime marrin fizionominë e valleve liriko-epike.

**Vallet epiko-lirike.** Ndryshe nga vallet liriko-epike, në vallet epiko-lirike mbizotërojnë gjallëria, burrëria dhe dinamika ("Kërcim burrash katundarshë"<sup>79</sup> - Hasi i Rrafshit Kosovë, "Më zu gjumi ke shatrivani"<sup>80</sup> - Shpat, rrethi Elbasan; "Vallja e belushës"<sup>81</sup> - Malësia e Tiranës, rrethi Tiranë).

Ndër vallet epiko-lirike mund të përfshihen edhe disa balada, siç është

75 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.43/3,99, 63/5.

76 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.43/3, 99, 63/5.

77 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.43/3, 99,63/5.

78 Përafërsisht për këtë shih AIKP, Kf.nr.170/3 (vallja "Mun te Borshi me të dalë" - fshati Borsh, Bregu i Detit të Poshtëm, rrethi Sarandë.

79 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.7/7; 166/10; 17/7 (shih edhe 85/4).

80 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.7/7; 166/10; 27/7 (shih edhe 85/4).

81 AIKP, përkatësisht, Kf.nr.7/7; 166/10; 27/7 (shih edhe 85/4).

për shembull "Balada e Murimit", ajo e "Fjalës së dhënë" dhe ndonjë tjetër, të cilat edhe sot e kësaj dite praktikohen duke u kërcyer në ndonjë zonë të Shqipërisë së Jugut.<sup>82</sup> Këto lloj baladash përshkohen nga rite e zakone të lashta, ku gërshetohen elemente të karakterit elegjiak e dramatik me elemente mitologjike e fantastike. Tiparet epiko-legjendare që i karakterizojnë ato kanë kushtëzuar një plastikë koreografike të zhdërvjellët dhe ekspresive, një lloj solemniteti në të kërcyer. Krijime të tilla përbëjnë një thesar të madh për kulturën tonë popullore.

Qerthulli i valleve epiko-lirike do të zgjerohej edhe më tepër në qoftë se brenda tyre do të përfshinin edhe "Kërcimin e tepsisë", që përbën një nga tipat origjinalë e më të lashtë të kërcimeve të grave të te revave veriore të Shqipërisë. (Kërcehet nga një grua dhe shoqërohet vetëm me ritmin e të rrotulluarit të tepsisë). Këtë mënyrë kërcimi e hasim sot të gjallë në folklorin koreografik të krahinës së Rugovës (Kosovë)<sup>83</sup>

Në vallet epiko-lirike një vend të dukshëm kanë edhe vallet e brezave<sup>84</sup>. Ky tip i ri kërcimesh, ku shkrihen në mënyrë organike tradicionalja dhe novatorja, me htjeshtësinë kompozicionale, forcën e madhe shprehëse dhe ekzekutimin dinjitoz, e ka gjallëruar dshe përtërirë së tepërmi vallëzimin tonë popullor. Duke bërë me sukses jetë aktive në veprimtarinë artistike, veçanërisht në festivalet folklorike lokale e kombëtare, valle të tilla flasin njëherësh për aftësitë e mëdha krijuese të bartësve popullorë. Gjithashtu, në vallet epiko-lirike mund të bëjnë pjesë edhe vallet e fëmijëve, kryesisht ato krijime që i përpshtaten moshës, shkallës së zhvillimit psikik dhe nivelit të tyre interpretues. "Kërcim fëmijësh"<sup>85</sup> - Dibër; "Valle devolliçe"<sup>86</sup> - Vranisht, rr ethi i Korçës etj.).

Studimi i përmbajtjes ideoemocionale përbën një ndër problemet më të rëndësishme shkencore për kulturën popullore koreografike shqiptare. Në këtë punim ajo u shqyrtua vetëm në vijat e saj më të përgjithshme, më themelore, më kryesore. Natyrisht, përmes studimeve të ardhshme etnokoreografike. Ky problem do të marrë zgjidhje më të gjera e më të thelluara.

82 Këtu kemi parasysh kryesisht krahinën e Mokrës së Pogradecit, me vallet "Qënkeshin tre vëllezër, zënkeshin të ndërtojnë një urë"; "Pse s'ha bukë e pse s'pi verë, more Ymer aga" etj. (AIKP, përkatësisht, Kf.nr.33/4, 10) dhe krahinën e Kurveleshit të Poshtëm, me vallen "Atje te ura në lumë" (Kf.nr.166/8)

83 AIKP, Kf.nr.89/8. (Kërcimi i tepsisë: "Ndras të vekut kush po kjna". fshati Harxhaj)

84 Kujtjojmë disa nga vallet e brezave të shfaqura në festivalet folklorike kombëtare, si: "Vallja e brezave" - Dibër; "Goraçja" - Korçë; "Hedhim vallen dy milion" - Gramsh; "Valle e brezave" - Librazhd; (AIKP, përkatësisht, Kf.nr.25/7; 157/13; 65/8; 81/11)

85 AIKP, përkatësisht Kf.nr.63/10; 70/10: 20/7

86 AIKP, përkatësisht Kf.nr.63/10; 70/10; 20/7

Ramazan Bogdani

Gjurmimet e kërkimit  
Folklorit dhe etnologjisë  
24 - 1994

## THE IDEO-EMOTIONAL CONTENT AND ALBANIAN FOLK DANCE

Folk dances can be analysed according to the ideo-emotional content, ethnographic and choreographic extension, expressive means etc. In this work they are studied from the ideo-emotional point of view, as the most fundamental criterion in analysing the Albanian choreographic, folk culture. A living and rich choreographic material, mainly filmed and accumulated during the last three to four decades has served as an argumentative basis for study. Such a work creates the possibility in the future to draw the comparison between our folk dances and those of the other peoples of the Balkans.

In the ideo-emotional content, two main genres are distinguished: lyric and epic. The notions of lyric and epic, which are used to characterize folklore as a whole, need to be further specified within the field of folk choreography. With the aim of correctly solving this question, it is indispensable to proceed from the specific and aesthetic essence of the dance, through the movement, plastics, gesture; hence through the dance; The most important criterion to classify the dance is the choreographic plastics. The main components of the dance are: the feet and bodily movements, the hands and head positions; Naturally, they are not separated from one another, but they are fully harmonized and unified and their wholeness presents what we call choreographic plastics. Consequently the division of dances according to genre is distinguished according to the lyric choreographic plastics and epic choreographic plastics.

Adhering to the general laws of the folklore aesthetics, devoted to work lyrical dances are divided as follows: 1 - Lyrical work dances; 2 - Ritual lyrical dances; 3 - Lyrical wedding dances; 4 - Lyrical erotic dances; 5 - Lyrical, humorous dances; 6 - Lyrical, pantomimic dances. Whereas the epic dances, are grouped into two kinds; 1 - Epic fighting dances; 2 - Epic dances of bravery.

On several cases, the lyrical, choreographic elements are interlaced with the epic, choreographic ones within a single dance, something which would constitute a third grouping or genre.

The lyric-epic dances and epic-lyric dances.

The different kinds of dances have been analysed in a general morphological domain, strictly adhering to certain theoretical-scientific criteria, on the basis of the living choreographic material.

1. *Novije Arvanita Apollonosa*, Kallpa, 1, Zagreb, 1978, 121-67; Vladimir Prop, *Morfološka nauka*, Beograd, 1963; Nadežda Mihajlović-Djordjević, *Zajednička tematska istraživanja arvanitskih mitoloških praznika i pjesne tradicije*, Beograd, 1971, 17-30.

